

EPPC Albania kërkon një **Përfaqësues Shitjesh (për Zonën e Jugut të Shqipërisë)** për klientin e saj, i cili është kompani lider në botë, në prodhimin e materialeve të ndërtimit.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Monitoron tregun, nevojat e klientëve dhe ofertat e konkurrentëve;
- Kryen aktivitete shitjeje;
- Bën propozime për modifikimin e politikave të çmimeve dhe politikave të biznesit nëse është e nevojshme për të arritur qëllimet strategjike;
- Bashkëpunon në projektet e Marketingut të kompanisë (panaire, promovime, etj.);
- Planifikon, përgatit dhe realizon evente promovuese;
- Vlerëson tregun dhe raporton në lidhje me zhvillimet dhe ndryshimet e tij;
- Raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i shitjeve.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë arsim të lartë;
- **Të jetë rezident në Fier ose Vlorë;**
- Përvojë të mëparshme pune si përfaqësues shitjesh;
- Aftësi të mira negociuese, komunikuese dhe ndërpersonale;
- **Të posedojë leje drejtimi dhe të ketë disponibilitet për të udhëtuar;**
- Njohja e gjuhës Angleze përbën avantazh;
- Të jetë miqësor dhe energjik me fokus shërbimin ndaj klientit.

Të dhënat:

Pozicioni:	Përfaqësues Shitjesh (për Jugun e Shqipërisë) ;
Vendndodhja:	Tiranë;
Raporton tek:	Menaxheri i shitjeve;
Pagesa:	Shumë e mirë (<i>fikse + bonuse+makinë</i>);
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	20.10.2019

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj deri në datë 20.10.2019, në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.